**REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO**
**KOMUNA E GJAKOVËS**
**OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA**

# Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 04.10.2022

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.2) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2 ) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 03.10.2022, të parashtruar nga Operatori Ekonomik **" VB.TOFAJ " SH.P.K.**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Rregullime dhe mirëmbajtje të shkollave " , Nr. i prokurimit- 632-22-9759-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-22-102-521, nxjerr:**

**V E N D I M**

1. **Aprovohet si pjesërisht e bazuar** kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit ekonomik **" VB.TOFAJ " SH.P.K., e dt.03.10.2022**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Rregullime dhe mirëmbajtje të shkollave " , Nr. i prokurimit- 632-22-9759-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-22-102-521,** kundër Dosjes së tenderit dhe Njoftimit për kontratë te AK – së, të datës 15.09.2022, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.

2. **Përmirësohet pjesërisht DOSJA E TENDERIT DHE NJOFTIMI PËR KONTRATË , i publikuar me datë: 15.09.2022;**

3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të bëj përmirësimin e pjesërishëm të Dosjes së tenderit dhe Njoftimit për kontratë.

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

**A r s y e t i m**

Operatori Ekonomik **" VB.TOFAJ " SH.P.K., me dt.03.10.2022,** ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim , lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Rregullime dhe mirëmbajtje të shkollave " , Nr. i prokurimit- 632-22-9759-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-22-102-521.**

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 04.10.2022, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pas shqyrtimit të Kërkesës për rishqyrtim të Operatorit Ekonomik **" VB.TOFAJ " SH.P.K.,, të dt.03.10.2022**, Autoriteti kontraktues, konstaton se pretendimet e Operatorit në fjalë, janë pjesërisht të bazuara, prandaj vendos që të bëj përmirësimin e pjesërishëm e dosjes së tenderit dhe Njoftimit për kontratë.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

**Këshilla juridike:**
Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqeseëankesë pranë OSHP-së . **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

**Faton Gutaj**

**Menaxher i Zyrës së Prokurimit**

**Kopje:** Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit te Komunës;
Te gjitha palëve te interesuara;